



## ZYRA E PROKURIMIT

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i AK-së në bazë të Nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke vendosur sipas Kërkesës së Parashtruar për Ri-Shqyrtim të dt.17.11.2020 nga Operatori Ekonomik "RISAMONT" SHPK Prishtinë, lidhur me Aktivitetin e Prokurimit "Mirëmbajtja e Ndrëçimit Publik" me Numër të Aktivitetit të Prokurimit 615-20-6401-2-2-1, nxjerrë këtë:

### VENDIM

Aprovohet si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e dt. 17.11.2020, lidhur me ankesën parashtruar nga OE "RISAMONT" SHPK Prishtinë, në aktivitetin e prokurimit " Mirëmbajtja e Ndrëçimit Publik" me nr. të Prokurimit: 615-20-6401-2-2-1, nr.Brendshëm 615-20-119-2-2-1

- Aktiviteti i prokurimit është pezulluar dhe kthehet në rivlerësim.

### Arsyetim

AK, Komuna e Podujevës pas shqyrtimit të kërkesës së OE "RISAMONT" SHPK Prishtinë, parashtruar kërkesën duke kërkuar nga AK - Komuna e Podujevës që ta aprovoj kërkesën për rishqyrtim dhe të kthej lëndën në Rivlerësim.

AK, Komuna e Podujevës ka analizuar kërkesën për rishqyrtim dhe ka aprovuar si pjesërisht të bazuar dhe vlerëson që aktiviteti i cekur i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

Nga se u cek, në bazë të Ligjit nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Udhëzim juridik:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë në OSHP.

Nr. 14-370/04-0071257/20  
Podujevë,  
20.11.2020

